

VENDIM
Nr.907, datë 19.12.2007

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.70, DATË 11.2.1999 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR EVIDENTIMIN E PUNËKËRKUESVE TË PAPUNË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 3 të ligjit nr.7995, datë 20.9.1995 “Për nxitjen e punësimit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.70, datë 11.2.1999 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Çdo person, që kërkon punë ose punë të re, regjistrohet si punëkërkues i papunë në zyrën përkatëse të punësimit, për të përfituar nga shërbimet e punësimit, programet aktive të punësimit, si dhe programet e tjera shtetërore të mbështetjes me të ardhura.”.

2. Në rreshtin e fundit të paragrafit të dytë të pikës 3, pas fjalëve “...libreza e rregullt e punësimit...” shtohen “... dhe e përcjell, periodikisht, këtë informacion në zyrën përkatëse të punësimit...”.

3. Në fund të pikës 4 shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Zyra përkatëse e punësimit pajis me vërtetim çdo punëkërkues të papunë, që përfiton ose do të përfitojë nga ofrimi i shërbimeve dhe programet aktive të punësimit, si edhe nga programet e tjera shtetërore të mbështetjes me të ardhura.”.

4. Në pikën 5 fjalët “...një muaj...” zëvendësohen me “...tre muaj...”.

5. Kudo në vendim fjalët “zyra kompetente e punësimit” zëvendësohet me “zyra përkatëse e punësimit”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha